

VENDIM
Nr. 256, datë 10.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 389, DATË 29.6.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PËR SHËRBIMET, PUNËT, BLERJEN E PAJISJEVE/MJETEVE, TË PROJEKTUARA POSAÇËRISHT OSE TË PËRSHTATURA PËR FUSHËN E SIGURISË DHE/OSE RENDIT PUBLIK, MATERIALET PËR QËLLIME OPERACIONALE, PËRFSHIRË TEKNOLOGJINË DHE *SOFTWARE*-ET E LIDHURA ME KËTO MALLRA, SI DHE PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VEÇANTË TË KLASIFIKIMIT TË KËTYRE KONTRATAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 389, datë 29.6.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Brendshme” dhe “ministri i Brendshëm” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Punëve të Brendshme” dhe “Ministri i Punëve të Brendshme”.

2. Në nenin 2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas shkronjës “c”, të pikës 4, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) të ardhura të krijuara nga tarifat për shërbime të ofruara nga strukturat e sigurisë dhe rendit publik ose shërbime të ofruara nga subjekte private të kontraktuara nga strukturat e sigurisë dhe rendit publik.”.

b) Pika 25 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“25. “Titullari i autoritetit kontraktor” është sipas rastit:

a) Ministri i Punëve të Brendshme.

b) Drejtori i Përgjithshëm i institucionit të varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme ose administratori i shoqërisë tregtare ku Ministria e Punëve të Brendshme zotëron më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të aksioneve ose kuotave.”.

3. Në pikën 1, të nenit 8, dhe në pikën 1, të nenit 9, emërtimi “ministrit të Brendshëm” zëvendësohet me fjalët “... titullarit të autoritetit kontraktor ...”.

4. Në fund të pikës 1, të nenit 10, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Komisioni i negocimit negocion klauzola specifike kontraktore, në përputhje me natyrën teknike dhe operacionale të projektit.”.

5. Pas pikës 3, të nenit 11, shtohen pikat 4, 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“4. Për projekte teknologjike, sisteme inteligjence dhe shërbime të vazhdueshme, të cilat financohen nga të ardhura të krijuara nga tarifa që paguhet për shërbimin dhe nuk mbështeten nga buxheti i shtetit, lejohet lidhja e kontratave afatgjata me faza implementimi dhe mirëmbajtjeje. Në këtë rast, kohëzgjatja përcaktohet nga titullari i autoritetit kontraktor, sipas natyrës së projektit/shërbimit ose bazuar në projeksionin e të ardhurave, për një periudhë deri në 7 (shtatë) vjet.

5. Kontratat shumëvjeçare, që lidhen sipas pikës 4, financohen tërësisht nga të ardhura tarifore, që nuk krijojnë detyrime të drejtpërdrejta ose të tërthorta ndaj buxhetit të shtetit. Autoriteti kontraktor duhet:

a) të hartojë projeksione shumëvjeçare të të ardhurave dhe kostove, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor;

b) të dokumentojë që struktura tarifore siguron mbulim të plotë të kostove gjatë gjithë periudhës së kontratës;

c) të deklarojë dhe të regjistrojë angazhimin financiar në sistemet përkatëse buxhetore;

ç) të garantojë se kontrata nuk krijon detyrime kontingjente, të nënkuptuara ose kërkesa për fonde nga buxheti i shtetit.

6. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për plotësimin e detyrimeve të raportimit financiar dhe shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura, sipas legjislacionit në fuqi.”.

6. Pas fjalisë së parë, të shkronjës “gj”, të pikës 2, të nenit 14, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Kushtet e kontratës mund të përfshijnë klauzola specifike për fazat e implementimit, mirëmbajtjen dhe përditësimin, pagesa të kushtëzuara nga performanca dhe zgjatjen e kontratës.”.

II. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama